




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>Z.D./DPK</u>	Br. Prot. <u>01-2770/15</u>
Nr. l faq.	Data
Broj stranica <u>2</u>	Datum <u>15.09.2015</u>
Nr. pages	Date
	PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	14.09.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	znj. Eta Morina
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesë për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit

E nderuara znj. Morina,

Lidhur me kërkesën tuaj të deponuar në Agjencinë kundër Korrupsionit me dt. 14.04.2015, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit për zyrtarin e prokurimit në KRU Hidromorava në Gjilan, z. Samet Idrizi, lidhur me tenderin: "Vlerësimi teknik dhe financiar të sistemeve urbane dhe rurale të rrjetit të ujësjellësit", në mbështetje të nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Ligji PKI),

NJOFTOHENI se:

Agjencia kundër Korrupsionit ka trajtuar këtë rast dhe me vendim ka konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Rasti është zhvilluar si vijon:

Në bazë informacioneve të ofruara nga ju, dyshimet për konflikt interesi kanë qenë se Autoriteti Kontraktues – “Hidromorava” Sh. A., ka shpallur fituese kompaninë “3D – Project” Sh.P.K., pronari i së cilës është vëllau i zyrtarit të prokurimit në këtë institucion.

Mirëpo, në bazë të dosjes së tenderit, të siguruar nga AKK, është konfirmuar se kompania fituese e këtij tenderi nuk është “3D – Project” Sh.P.K. për të cilën ju keni hedhur dyshimet për konflikt interesi. Fitues i këtij tenderi, është kompania N.Sh. “3 D - Project”, në të cilën nuk është pronar vëllau i zyrtarit të prokurimit. I njëjti nuk mban ndonjë funksion tjetër në këtë kompani.

Andaj, bazuar në nenin 18 (pika 10) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, duke marrë parasysh të gjitha faktet që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, kemi vlerësuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Agjencia Kundër Korrupsionit u është mirënjohës për bashkëpunimin tuaj dhe iu inkurajon që të vazhdoni këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Me respekt!